

Nga normalizimi deri tek autocensura –



ANALIZË e ngacmimeve online ndaj gazetareve në Maqedoninë e Veriut

Nga normalizimi deri tek autocensura –

ANALIZË
e ngacmimeve online
ndaj gazetareve
në Maqedoninë e Veriut

Botues: Platforma për Gazetari Hulomtuese dhe Analiza

Bashkëbotues: Misioni i OSBE-së në Shkup

Autore: Bojana Jovanovska

Redaktore: Kristina Ozimec

Titulli i origjinalit (në maqedonisht): Од нормализација до самоцензура – Анализа на онлајн вознемирувањето врз новинарките во Северна Македонија

Përkthyer nga gjuha maqedonase në shqip - Valon Abdiu

Lekturimi: Lulzim Ademi

Dizajn grafik dhe shtypi: Polyesterday

Hulumtimi:

Ivana Mitrovska

Marina Lazarevska

Silvana Zhezhova-Stankovska

2022, Shkup

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

316.647.5:004.738.5]:070.422-055.2(497.7)(047.31)

364.634:004.738.5]:070.422-055.2(497.7)(047.31)

JOVANOVSKA, Bojana

Nga normalizimi deri tek autocensura [Електронски извор] : analizë e ngacmimeve online ndaj gazetareve në Maqedoninë e Veriut / [autore Bojana Jovanovska ; përkthyer nga gjuha maqedonase në shqip Valon Abdiu]. - Shkup : Platforma për gazetari hulomtuese dhe analiza: Misioni i OSBE-së në Shkup, 2022

Начин на пристапување (URL):

<https://www.osce.org/sq/mission-to-skopje/526991>. - Превод на делото: Од нормализација до самоцензура : анализа на онлајн вознемирувањето врз новинарките во Северна Македонија. - Текст во ПДФ формат, содржи 48 стр., илустр. - Фусноти кон тектот. - Библиографија: стр. 46-48

ISBN 978-608-5014-03-3 (Platforma për gazetari hulomtuese dhe analiza)

ISBN 978-608-4788-85-0 (Misioni i OSBE-së në Shkup)

a) Новинарки -- Вознемирување -- Интернет -- Македонија -- Истражувања

COBISS.MK-ID 58362117

/ PËRMBAJTJA /

HYRJE	4
METODOLOGJIA	7
ANALIZË	8
Analizë e përmbajtjes.....	8
Anketa.....	16
Intervistat me palët përkatëse të interesit.....	33
PËRFUNDIME	39
REKOMANDIME	42
BIBLIOGRAFIA	46

/ HYRJJE /

Qëllimi i ngacmimeve dhe sulmeve në hapësirën digjitale është të heshten zërat e atyre ndaj të cilëve janë drejtuar ato. Megjithatë, duke pasur parasysh lirinë që e ofron hapësira digjitale dhe mundësitë (në dukje) të pakufishme për komunikim, ngacmimi online prek jo vetëm personin të cilit i drejtohet, por edhe të gjithë ata që e lexojnë atë. Prandaj, si viktimë indirekte e mesazhit që i drejtohet një individit të caktuar paraqitet edhe një grup i caktuar njerëzish që ndajnë disa karakteristika të identitetit, mendime, qëndrime të përbashkëta me viktimën kryesore të sulmit online. Ngacmuesi, përmes qëllimit të vet për ta disiplinuar viktimën, arrin të ndikojë edhe në sjelljen e publikut më të gjerë që identifikohet me viktimën. Andaj, ngacmimet dhe sulmet online ndaj gazetareve në sfond kanë synimin për t'i heshtur të gjitha gazetaret, por edhe të gjitha gratë.

Rrënjët e heshtjes së zërit të grave i gjejmë në sistemin patriarkal të vlerave, degët e të cilit ende depërtojnë në të gjitha sferat e shoqërisë sonë dhe brenda të cilit ushqehen me kujdes rolet dhe stereotipat tradicionale gjinore. Në gazetari, ndonëse ajo gjithnjë e më shumë karakterizohet si profesion “femëror”, në radhë të parë për shkak të rritjes së numrit të grave që merren me këtë profesion, megjithatë është e qartë mospërputhja kur bëhet fjalë për praninë e grave në proceset vendimmarrëse, e veçanërisht në kuadër të qendrave të fuqisë.

Duke marrë parasysh se gratë në mënyrë disproporcionale janë shumë më të prekura nga fenomeni i dhunës me bazë gjinore në botën fizike, karakteristikat me bazë gjinore të dhunës në fakt vetëm u pasqyruan në fenomenologjinë e saj edhe në hapësirën digjitale. “Hapësira e re”, e cila i promovon parimet e zhvillimit dhe lirisë, në vend që të kontribuojë në një lloj evoluimi të roleve gjinore, në fakt përfaqëson vetëm një vazhdimësi të strukturave patriarkale.

Pavarësisht se zhvillimi i teknologjive të reja të komunikimit dhe zgjerimi i hapësirës digjitale mundësoi vokalizimin e një numri të madh individësh që nuk e patën këtë mundësi në botën offline, megjithatë imponoi sfida të reja, por edhe rreziqe serioze për të gjithë, sidomos për ata njerëz, profesionistë të cilëve është i lidhur ngushtë me publikun, siç është gazetaria. Pra, nga njëra anë, gazetaret fituan më shumë mundësi për dukshmëri, zhvillim dhe promovim të punës dhe pikëpamjeve të tyre, që nga ana tjetër nënkupton edhe ekspozim më të madh ndaj dhunës online, sepse *të jesh grua dhe të kesh mendimin tënd mund*

të jetë një kombinim i rrezikshëm në hapësirën digjitale.¹

Fillimi i vitit 2020 solli edhe pandeminë e virusit Covid-19, i cili e ndryshoi në mënyrë drastike mënyrën e jetesës dhe veçanërisht mënyrën e komunikimit. Duke marrë parasysh domosdoshmërinë e distancimit social në hapësirën fizike, si masë për mbrojtjen nga infektimi me virusin, një pjesë gjithnjë e më e madhe e komunikimit dhe socializimit u zhvendos në hapësirën digjitale. Kjo ka kontribuar për një rritje drastike të ngacmimeve dhe dhunës online. Pandemia shkaktoi rritje të dhunës ndaj grave, të cilat, për shkak të masave kufizuese u gjendën të mbyllura në shtëpitë e tyre me autorët e krimit, gjë që u përhap në të njëjtën mënyrë në hapësirën digjitale.

Megjithëse Maqedonia e Veriut ka bërë përparim të vogël në vitin 2021 sipas Indeksit të Lirisë së Mediave, megjithatë, raporti i Reporterëve pa Kufij tregon se situata me mediat është përkeqësuar, duke pasur parasysh se zyrtarët qeveritarë kanë vazhduar t'i kërcënojnë dhe t'i ofendojnë mediat, ndërsa kërcënimet dhe sulmet verbale në internet ndaj gazetarëve janë në rritje në rrjetet sociale.² Duke pasur parasysh se viteve të fundit, partitë politike në vend kanë njohur rolin e hapësirës digjitale, veçanërisht të mediave sociale në krijimin dhe kontrollin e narrativeve publike, hapësira digjitale është shndërruar në një fushë beteje të qendrave të ndryshme të fuqisë në vend. Si rezultat i kësaj, është rritur mundësia për tu cenuar e atyre që japin komente kritike para publikut në lidhje me narrativet që plasohen.

Në periudhën e kaluar, njohuritë nga terreni, si dhe të dhënat nga hulumtimet e shoqatave gazetareske tregojnë se gazetaret në vendin tonë gjithnjë e më shumë po përballen me ngacmime dhe sulme në hapësirën digjitale gjatë kryerjes së punës së tyre.³ Duke marrë parasysh rëndësinë e kësaj çështjeje, e cila është trajtuar në mënyrë të pamjaftueshme në opinion, si dhe për shkak

¹ Antonijevic, Z. (2016). The media cannot be truly free if women's voices are silenced. Në: New Challenges to Freedom of Expression: Countering Online Abuse of Female Journalists. OSCE. Gjetet në: <https://www.osce.org/files/f/documents/c/3/220411.pdf>

² SHGM. (2021). Analizë: Liria e mediave dhe siguria e gazetarëve në RMV përmes prizmit të zgjidhjeve ekzistuese ligjore - Si të arrijmë deri te zgjidhjet më të mira? Gjetet në: <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2021/06/publikacija-MK-internet-1.pdf>

³ Shih më shumë në Spirovski, M. dhe Nasteska Kallanoska, B. (2022). Maqedonia e Veriut: Treguesit për shkallën e lirisë së mediave dhe për sigurinë e gazetarëve në vitin 2021. SHGM. Gjetet në: <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2022/05/MK-MK-2021-finalen-izvestaj.pdf> dhe Tuneva, M. dhe Sandev, L. (2022). Siguria e gazetarëve dhe punonjësve mediaticë – realitet apo ndëshkim i vazhdueshëm. SHGM. Gjetet në: https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2022/03/MK_Bezbednost-na-novinarite-i-mediumskite-rabotnici-130322.pdf

të normalizimit të ngjarjeve të këtij lloji që mund të kenë pasoja të rënda mbi punën e gazetareve, si dhe mbi sigurinë e tyre, kjo analizë u fokusua në një hulumtim më të thelluar të situatës, me qëllim që të fitohen të dhëna relevante. Përmes përgatitjes së kësaj analize, në kuadër të projektit “Promovimi i sigurisë së gazetareve dhe standardeve profesionale në media”, i mbështetur nga Misioni i OSBE-së në Shkup, Platforma për Gazetari Hulumtuese dhe Analiza – PINA, si organizatë që punon prej disa vitesh për të ndryshuar vetëdijen për pozitën e gazetareve në shoqërinë e Maqedonisë së Veriut, do të përpiqet të japë kontribut për aktualizimin e kësaj teme. Prandaj, kjo analizë synon të ofrojë një pasqyrë të situatës me ngacmimet dhe sulmet në internet ndaj gazetareve në Maqedoninë e Veriut, si një formë e dhunës me bazë gjinore, si dhe identifikimin e zgjidhjeve të mundshme për të kapërcyer problemin, mekanizmat dhe burimet për të siguruar mbrojtje dhe ndihmë adekuate.

/ METODOLOGJIA /

Për përgatitjen e kësaj analize është zbatuar një metodë e kombinuar e hulumtimit, e cila përbëhet nga analiza sasiore dhe cilësore e të dhënave parësore dhe dytësore. Me këtë rast, të dhënat për analizën u mbledhën përmes aplikimit të disa instrumenteve hulumtuese:

- 1. Analiza e përmbajtjes** – hulumtime, raporte, analiza juridike dhe publikime të tjera të botuara në këtë fushë, rregulloret vendore dhe ndërkombëtare;
- 2. Anketa** – në muajin maj të vitit 2022, përmes platformës Google Forms u realizua një pyetësor online, të cilit iu përgjigjën 103 gazetarë. Në Maqedoninë e Veriut nuk ka të dhëna zyrtare për numrin e gazetarëve, e rrjedhimisht edhe të gazetarëve. Sipas vlerësimeve të aktorëve të ndryshëm që punojnë në këtë fushë, numri i gazetarëve në vend është ndërmjet 250 dhe 350. Të dhënat e fundit për anëtarësinë e Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë tregojnë një numër prej 293 femrave kundrejt 329 meshkujve, ku përveç gazetarëve dhe gazetarëve janë përfshirë edhe punëtorët e tjerë mediatik. Përveç kësaj, jo të gjithë gazetarët dhe gazetarët janë anëtarë të Shoqatës. Bazuar në këto vlerësime, në anketë u përfshinë ndërmjet 30% dhe 40% të gazetarëve që punojnë në vend. Krijimi i pyetësorit, si dhe procesi i anketimit, u krye nga PINA - Platforma për Gazetari Hulumtuese dhe Analiza. Pyetësori përbëhet nga gjithsej 40 pyetje, të cilat ishin grupuar sipas disa njësive tematike. Në procesin e analizimit të të dhënave nga anketa e kryer, përgjigjet e pyetjeve u grupuan sipas njësive tematike që ndryshojnë pjesërisht nga ato të përcaktuara fillimisht, për të pasur një renditje më të përshtatshme të përgjigjeve.
- 3. Intervista me palët e interesuara relevante** – janë realizuar gjithsej 4 intervista gjysmë të strukturuar me aktorë relevantë që punojnë në fushën e gazetarisë dhe/ose të dhunës me bazë gjinore, me fokus në hapësirën digjitale. Për qëllime të kësaj analize, në tekstin kryesor janë ndarë vetëm të dhënat më të rëndësishme.

/ ANALIZË /

Analizë e përmbajtjes

Statistikat mbi përhapjen e dhunës me bazë gjinore, të cilat janë në dispozicion në Maqedoninë e Veriut, tregojnë se jetojmë në një mjedis ku dhuna ndaj femrave është e përditshme dhe pikërisht një nga problemet kryesore është normalizimi i dhunës, e cila është e përhapur gjerësisht në vendin tonë. Një nga hulumtimet më të fundit të OSBE-së në vend,⁴ tregon se shumica e grave dhunën e konsiderojnë si një dukuri të zakonshme dhe çështje private, gjë që në fakt tregon për nivelin e ulët të ndërgjegjësimit, si për dhunën, ashtu edhe për pasojat e saj fatale.

Viteve të fundit ka pasur një rritje graduale të interesit për t'u përballur me dhunën digjitale, e veçanërisht me pasojat negative të saj, gjë që shihet nga numri në rritje i hulumtimeve dhe publikimeve që trajtojnë këtë problem. Megjithatë, dhuna digjitale, e veçanërisht dimensioni i saj gjinor, nuk është ende mjaft i hulumtuar në vendin tonë. Arsyet mund të gjenden në ndjeshmërinë e pamjaftueshme gjinore të publikut dhe të institucioneve relevante, por edhe në faktin se hapësira digjitale në vend është një fushë shumë pak e njohur, e njëkohësisht edhe e rregulluar ligjërisht.

Dhuna me bazë gjinore në hapësirën digjitale është një grup veprimesh të dhunshme të drejtuara ndaj grave dhe vajzave për shkak të identitetit të tyre gjinor, të kryera ose të ndihmuara, pjesërisht ose plotësisht, duke përdorur teknologji të informacionit dhe të komunikimit, të cilat si rezultat mund të çojnë në pasoja serioze për shëndetin, integritetin dhe dinjitetin e viktimës dhe miqve apo familjes së saj të ngushtë, si dhe ta çojnë viktimën në një gjendje të rrezikshme për jetën.⁵ Në kontekstin e profesionit, dhuna digjitale ndaj gazetareve dhe punonjëseve të tjera mediatike përfaqëson një sulm të drejtpërdrejtë mbi dukshmërinë e tyre dhe mundësinë e pjesëmarrjes së plotë në jetën publike.⁶

⁴ OSBE. (2019) Hulumtimi i kryer nga OSBE-ja mbi dhunën ndaj grave në Maqedoninë e Veriut: Mirëqenia dhe siguria e grave. Gjetet në: https://www.osce.org/files/f/documents/5/4/424409_0.pdf

⁵ Petkovska, N. dhe Leshoska, V. (2021). Për kë është interneti një vend i sigurt? Dhuna me bazë gjinore në hapësirën online. Gjetet në: <https://glasprotivnasilstvo.org.mk/wp-content/uploads/2021/12/Za-kogo-internetot-e-bezbedno-mesto-finalno-docx.pdf>

⁶ UN. (2020). Combating violence against women journalists: Report of the Special Rapporteur on violence against women, its causes and consequences. Gjetet në: <https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/G20/109/79/PDF/G2010979.pdf?OpenElement>

Platformat e reja digjitale për informim publik, përveç aspekteve pozitive, kanë sjellë edhe presione shtesë mbi gazetarët dhe punonjësit mediatik, përfshi edhe ekspozimin ndaj kërcënimeve dhe sulmeve online.⁷ Pavarësisht se gazetaria është një profesion në të cilin ka rrezik dhe ekspozim ndaj dhunës në mënyrë të barabartë si për gazetaret ashtu edhe për gazetarët, sulmet ndaj gazetaeve janë të bazuara në gjini dhe të seksualizuara, si në internet ashtu edhe jashtë tij, duke pasur parasysh se gazetaret janë në shënjestër jo vetëm për përmbajtjen e raportimit të tyre, por edhe për vetë faktin se janë gra që guxojnë të flasin publikisht.⁸ Frika nga ngacmimet dhe sulmet ndryshon sjelljen dhe veprimet e gazetaeve, duke kontribuar kështu në shfaqjen e problemeve psikologjike, autocensurës, mbylljes së profileve personale në rrjetet sociale, si dhe në rishqyrtimin e zgjedhjes së tyre profesionale.⁹

Sipas të dhënave nga hulumtimi i Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve, madje 64% e gazetaeve janë përballur me dhunë online, nga të cilat pothuajse gjysma (47%) nuk e kanë raportuar rastin.¹⁰ I njëjti hulumtim tregon të dhëna shqetësuese për ndikimin e dhunës online, duke shkaktuar pasoja të rënda psikologjike, si stres dhe ankth te 63%, autocensurë te 38% dhe humbje të vendit të punës te 8% të gazetaeve.

Të dhënat e fundit nga Reporterët pa Kufij për Maqedoninë e Veriut flasin për hapjen e hapësirës “së re” për sulme me bazë gjinore ndaj gazetaeve. Sipas të dhënave, pavarësisht se nuk ka kufizime të qarta në mjedisin social dhe kulturor që ndikojnë në gazetarinë e lirë, rrjetet sociale dhe sfera digjitale në përgjithësi favorizojnë përhapjen e keqinformimit dhe kërcënimeve kibernetike, të cilat, të kombinuara me standardet e ulëta profesionale, kontribuojnë në rënien e besimit të publikut në media dhe hapjen e rrugës për sulme ndaj gazetarëve në bazë të kriterëve gjinore, etnike apo fetare.¹¹

⁷ Bejkova Josheska, B. dhe Xhigall, S. (2022). Analizë – Siguria dhe situata socio-ekonomike në media: Me veprim të përbashkët deri te respektimi më i madh i të drejtave të gazetarëve dhe punonjësve mediatikë. SHGM dhe SPGPM. <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2022/03/Bezbedni-Mediumski-Rabotnici-Analiza-Book-WEB-MKD.pdf>

⁸ Khan, I. (2021). #JournalistsToo – Women Journalists Speak Out. Gjetendet në: https://srfreedex.org/wp-content/uploads/2021/11/JT_English.pdf

⁹ Ferrier, M. (2018). Attacks and Harassment: The Impact on Female Journalists and Their Reporting. International Women’s Media Foundation. Gjetendet në: <https://www.iwmf.org/wp-content/uploads/2018/09/Attacks-and-Harassment.pdf>

¹⁰ IFJ global survey shows massive impact of online abuse on women journalists. <https://www.ifj.org/media-centre/news/detail/article/ifj-global-survey-shows-massive-impact-of-online-abuse-on-women-journalists.html>

¹¹ Reporters without Borders. Gjetendet në: <https://rsf.org/en/country/north-macedonia>

Përkundër faktit se nuk ka të dhëna të sakta statistikore në Maqedoninë e Veriut nëse gazetaret dhe punonjëset mediatike janë më të ekspozuara ndaj sulmeve, presioneve, ngacmimeve dhe shantazheve, megjithatë, përshtypja e përgjithshme është se mjedisi në të cilin jetojmë lejon që gazetaret të jenë cak i ofendimeve më të mëdha se sa kolegët e tyre, vetëm për faktin se janë gra.¹² Stereotipat gjinore pasqyrohen në përmbajtjen e komenteve dhe mesazheve drejtuar gazetareve, të cilat shumë më shpesh lidhen me pamjen e tyre fizike sesa me punën e tyre. Prandaj, gazetaret më shpesh u nënshtrohen fyerjeve dhe nënçmimeve që ua prishin reputacionin e tyre personal dhe profesional, me kualifikime që u referohen vetëm grave, në kuptimin poshtërues.¹³

Pandemia e dhunës me bazë gjinore që ishte një nga efektet anësore të pandemisë së virusit Kovid-19 u përhap edhe në hapësirën digjitale, kështu që në vitin 2020, pavarësisht se numri i sulmeve fizike ndaj gazetarëve është ulur, është vërejtur një trend në rritje i dhunës online dhe abuzimeve verbale.¹⁴

Për dimensionin gjinor të sulmeve online ndaj gazetareve në vend flasin të dhënat sipas të cilave më shumë se gjysma e sulmeve totale ndaj gazetareve në vitin 2020 dhe 2021, janë kundër gazetareve, edhe atë duke përdorur platformat në internet apo rrjetet sociale,¹⁵ Sulmet online ndaj gazetareve gjatë kryerjes së punës së tyre janë përforcuar më tej edhe me diskriminim seksist dhe mizogjen.¹⁶ Me këtë rast, edhe kërcënimet që i marrin gazetarët kryesisht janë dërguar përmes rrjeteve sociale.¹⁷

¹² Tuneva, M. dhe Sandev, L. (2022). Siguria e gazetarëve dhe punonjësve mediatik – realitet apo ndëshkim i vazhdueshëm. SHGM. Gjetend në: https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2022/03/MK_Bezbednost-na-novinarite-i-mediumskite-rabotnici-130322.pdf

¹³ Spirovski, M. dhe Nasteska Kallanoska, B. (2022). Maqedonia e Veriut: Treguesit për shkallën e lirisë së mediave dhe për sigurinë e gazetarëve në vitin 2021. SHGM. Gjetend në: <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2022/05/MK-MK-2021-finalen-izvestaj.pdf>

¹⁴ US Department of State. (2021). 2020 Country Reports on Human Rights Practices: North Macedonia. Gjetend në: <https://www.state.gov/reports/2020-country-reports-on-human-rights-practices/north-macedonia/>

¹⁵ Sulejman, D. dhe Breshkovski, I. (2022). Sulmet ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik 2017-2021 – Tendenca dhe rekomandime. SHGM. <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2022/06/Attacks-on-journalists-MK-310322.pdf>

¹⁶ Sulejman, D. dhe Breshkovski, I. (2022). Sulmet ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik 2017-2021 – Tendenca dhe rekomandime. SHGM. <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2022/06/Attacks-on-journalists-MK-310322.pdf>

¹⁷ Bejkova Josheska, B. dhe Xhigall, S. (2022). Analizë – Siguria dhe situata socio-ekonomike në media: Me veprim të përbashkët deri te respektimi më i madh i të drejtave të gazetarëve dhe punonjësve mediatik. SHGM dhe SPGPM. <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2022/03/Bezbedni-Mediumski-Rabotnici-Analiza-Book-WEB-MKD.pdf>

Format e ndryshme të diskriminimit me bazë gjinore me të cilat përballen gazetaret në kuadër të organizatës ku ato punojnë, por edhe nga publiku i gjerë, si dhe të dhënat për strukturën gjinore të pronësisë dhe punonjësve në nivelet që kanë fuqinë për të marrë vendime, të cilat tregojnë një përfaqësim më të ulët të grave në këto pozita,¹⁸ e imponon rrezikun e përfshirjes së tyre të pamjaftueshme në proceset vendimmarrëse që do t'i shprehin në mënyrë adekuate nevojat specifike të femrave në profesionin e gazetarisë, përfshi edhe miratimin e politikave dhe ligjeve në këtë fushë.

Analizat e deritanishme të legjislacionit kombëtar në këtë fushë, si dhe përputhshmëria e tij me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e gazetarëve, tregojnë qartë nevojën për ndryshime në legjislacion, në drejtim të parandalimit dhe mbrojtjes nga sulmet ndaj gazetarëve dhe punonjësve të tjerë mediatik. Sipas Reporterëve pa Kufij, megjithëse Kushtetuta garanton lirinë e fjalës dhe ndalon censurën, Maqedonia e Veriut mbetet prapa në harmonizimin e legjislacionit të mediave me standardet e Bashkimit Evropian.¹⁹

Gjithashtu, legjislacioni në fushën e mbrojtjes së femrave nga dhuna në hapësirën digjitale është pothuajse jo ekzistuese. Mungesa e saj dëshmohet edhe nga rasti i fundit “Dhoma publike”, ku ndër qindra femra, viktima ishin edhe disa gazetare, gjë që vërtetoi se ligji në raste të tilla i mbron vetëm të miturit.

Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje,²⁰ i cili ka hyrë në fuqi më 6 maj të vitit 2021, përfshin një përkufizim të ngacmimit seksual në internet si çdo sjellje verbale, *jo verbale ose sjellje tjetër të natyrës seksuale, që ka si qëllim ose efekt, cenimin e dinjitetit ose krijimin e një mjedisi, qasjeje ose praktike kërcënuese, armiqësore, poshtëruese ose frikësuese, nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit*. Megjithatë, pavarësisht nga miratimi i ligjit, i cili në masë të madhe është në përputhje me Konventën e Stambollit, megjithatë, më shumë se një vit pas hyrjes në fuqi të tij, ndryshimet në Kodin Penal në drejtim të kriminalizimit të veprave të parashikuara në këtë ligj, ende nuk janë miratuar.

¹⁸ Starova, N. (2022). Boshllëqet kryesore sistimore dhe zgjidhjet e mundshme për të tejkaluar hendekun e rrogave dhe problemet potenciale me vendosjen hierarkike në media të bazuara në diskriminimin gjinor – dokument politikash. SHGM. Gjetet në: https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2022/02/AJM_BTD_Rodova-diskriminacija-vo-mediumite_MK_AL_EN-1.pdf

¹⁹ Reporters without Borders. Gjetet në: <https://rsf.org/en/country/north-macedonia>

²⁰ Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. (2021). Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje.

Sipas analizave të organizatave gazetareske në vend, ndryshimet e propozuara në Kodin Penal i specifikojnë më tej instrumentet ligjore dhe veprat penale të cilat deri më tani nuk ishin të mbuluara me ligj, me qëllim që t'i mbrojnë femrat nga ngacmimet dhe sulmet.²¹ Me ndryshimet e propozuara, futet edhe një vepër e re penale “përndjekje”, me të cilën ai që vazhdimisht ndjek, persekuton ose ndërhyt në jetën personale të një tjetri pa autorizim, ose vendos ose përipiqet të vendosë kontakte të padëshiruara me të duke lëvizur në hapësirën ku ndodhet ai person, duke keqpërdorur përdorimin e të dhënave personale, duke përdorur mjete të informimit publik ose mjete të tjera të komunikimit, ose në mënyrë tjetër e keqtrajton, ngacmon ose frikëson atë në mënyrë psikologjike dhe në këtë mënyrë i shkakton ndjenjën e pasigurisë, ankthit ose frikës për sigurinë e tij/saj ose të një personi të tij/saj të afërt, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në tri vjet. Duke pasur parasysh se e përcaktuar në këtë mënyrë, përndjekja do ta mbulojë dhe në këtë mënyrë edhe do ta sanksionojë ngacmimin në hapësirën digjitale, pritet që të kontribuojë në rritjen e sigurisë së gazetareve në këtë fushë të veprimit.

Megjithatë, miratimi i një rregullore ligjore nuk nënkupton domosdoshmërisht edhe zbatimin adekuat të saj. Ajo që akoma mungon seriozisht është ofrimi i një reagimi efikas ndaj dhunës online nga nga ana e udhëheqjes dhe organet e zbatimi të ligjit.²²

Të gjitha hulumtimet dhe raportet e deritanishme në këtë fushë, pa përjashtim, tregojnë për një shkallë të lartë mosbesimi ndaj institucioneve, qofshin ato policia, prokuroria apo gjyqësori. Mosbesimi bazohet në mosveprimin ose veprimin joadekuat të tyre, efikasitetin e pamjaftueshëm në zhvillimin e procedurave, pakënaqësinë me rezultatet e procedurave, gjegjësisht mos sanksionimin e ngacmimeve dhe sulmeve online. Karakteristikë e sulmeve ndaj gazetarëve në Maqedoninë e Veriut është se ato nuk trajtohen me shkallën e nevojshme të seriozitetit nga institucionet kompetente. Një numër shumë i vogël i rasteve kanë përfundim gjyqësor, ndërsa pjesa më e madhe e rasteve të raportuara të sulmeve ndaj gazetarëve përfundojnë me raport në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) ose në Prokurorinë Themelore Publike (PTHP), pa u

²¹ Bejkova Joeska, B. dhe Xhigall, S. (2022). Analizë – Siguria dhe situata socio-ekonomike në media: Me veprim të përbashkët deri te respektimi më i madh i të drejtave të gazetarëve dhe punonjësve mediatikë. SHGM dhe SPGPM. <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2022/03/Bezbedni-Mediumski-Rabotnici-Analiza-Book-WEB-MKD.pdf>

²² Ferrier, M. (2018). Attacks and Harassment: The Impact on Female Journalists and Their Reporting. International Women's Media Foundation. Gjetendet në: <https://www.iwmf.org/wp-content/uploads/2018/09/Attacks-and-Harassment.pdf>

përcjellë në gjykata, ose refuzohen.²³

Sipas një hulumtimi për sigurinë e gazetarëve në vend, nga gazetarët që kanë marrë kërcënime, 14,9% nuk i kanë raportuar ato për shkak të mosbesimit në gjyqësor, 14% për shkak të mosbesimit në polici dhe 13,7% për shkak të mosbesimit në prokurori.²⁴ Në rastin e dhunës online, gazetarët zakonisht në fillim e informojnë publikun përmes mediave të tyre dhe përmes profileve të tyre në rrjetet sociale, pastaj e raportojnë rastin tek shoqatat, ndërsa hapi i tretë është raportimi në institucionin përkatës.²⁵

Të dhënat e analizës së Shoqatës së Gazetarëve të vitit 2021 tregojnë se institucionet janë inerte dhe jo efektive në përpunimin e rasteve dhe lëndëve në të cilat janë përfshirë profesionistë të mediave.²⁶ E gjithë kjo kontribuon në praninë e vazhdueshme të trendit të dekurajimit të gazetarëve për t'i raportuar rastet e sulmeve, duke marrë parasysh rastet e kërcënimeve serioze online ndaj gazetarëve, për të cilat institucionet nuk ishin mjaft efikase në zbulimin dhe ndëshkimin e sulmuesve.²⁷

Në të njëjtën kohë, edhe Komisioni Evropian, në raportin e fundit për progresin e Maqedonisë së Veriut, vë në dukje rritjen e kërcënimeve nga ana e politikanëve dhe funksionarëve publikë të ngacmimeve online dhe sulmeve verbale ndaj gazetarëve, përfshi edhe në rrjetet sociale, duke theksuar se qeveria dhe sistemi gjyqësor duhet të demonstrojë një dënim më aktiv dhe sistematik të sulmeve,

²³ Ristova, O. (2022). Boshllëqet kryesore sistimore dhe zgjidhjet e mundshme për të përmirësuar mjedisin e përgjithshëm në shoqëri, nga aspekti i sigurisë së gazetarëve dhe punonjësve mediatik - dokument politikash. SHGM. Gjetet në: https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2022/02/AJM_BTD_Bezbednost-novinarite_MK_AL_EN.pdf

²⁴ Bejkova Joeska, B. dhe Xhigall, S. (2022). Analizë – Siguria dhe situata socio-ekonomike në media: Me veprim të përbashkët deri te respektimi më i madh i të drejtave të gazetarëve dhe punonjësve mediatik. SHGM dhe SPGPM. <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2022/03/Bezbedni-Mediumski-Rabotnici-Analiza-Book-WEB-MKD.pdf>

²⁵ Ristova, O. (2022). Boshllëqet kryesore sistimore dhe zgjidhjet e mundshme për të përmirësuar mjedisin e përgjithshëm në shoqëri, nga aspekti i sigurisë së gazetarëve dhe punonjësve mediatik - dokument politikash. SHGM. Gjetet në: https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2022/02/AJM_BTD_Bezbednost-novinarite_MK_AL_EN.pdf

²⁶ SHGM. (2021). Analizë: Liria e mediave dhe siguria e gazetarëve në RMV përmes prizmit të zgjidhjeve ekzistuese ligjore - Si të arrijmë deri te zgjidhjet më të mira? Gjetet në: <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2021/06/publikacija-MK-internet-1.pdf>

²⁷ Spirovski, M. dhe Nasteska Kallanoska, B. (2022). Maqedonia e Veriut: Treguesit për shkallën e lirisë së mediave dhe për sigurinë e gazetarëve në vitin 2021. SHGM. Gjetet në: <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2022/05/MK-MK-2021-finalen-izvestaj.pdf>

duke pasur parasysh se vetëm një numër i vogël i autorëve të sulmeve ndaj gazetarëve janë sjellë para drejtësisë.²⁸

Analiza e paradokohshme «Sulmet ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik 2017-2021»²⁹ ofroi një pasqyrë të praktikës në rastet e dhunës online, para së gjithash përmes veprimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, si i vetmi institucion që ka qasje në mekanizmat për mbledhjen e provave në hapësirën digjitale përmes Sektorit për Krimin Kompjuterik dhe Forenzikën Digjitale dhe Prokurorisë, e cila merr vendimin përfundimtar për zhvillimin e procedurës penale. Duke pasur parasysh se procedura për gjetjen e sulmuesve në hapësirën digjitale është e vështirë dhe e ngadaltë, nga shkaku se kërkon që institucionet vendase t'u drejtohen atyre jashtë vendit duke përdorur instrumente të ndihmës juridike ndërkombëtare gjatë mbledhjes së informacionit në procedurën parahetimore edhe atë nëpërmjet ministrisë përkatëse, shumica e procedurave zgjasin shumë dhe përfundojnë me dështim. Përveç kësaj, sulmet shpesh vijnë nga profile anonime ose të ashtuquajtura «bot»-e, që përdorin rrjete private virtuale dhe mund të fshehin lehtësisht gjurmët e tyre në sferën online.³⁰ Në të njëjtën kohë, analiza tregon edhe për praninë e standardeve të dyfishta për sa i përket shpejtësisë në veprimet e institucioneve në rastet e sulmeve online ndaj gazetarëve, për dallim nga veprimet në rastet kur sulmohet ndonjë funksionar i qeverisë.³¹

Institucionet kompetente, në radhë të parë Ministria e Punëve të Brendshme dhe Prokuroria Themelore Publike, nuk kanë krijuar departamente të posaçme apo nuk kanë emëruar persona përgjegjës për kryerjen e hetimeve dhe procedurave lidhur me aktet e dhunës ndaj gazetarëve.³²

²⁸ European Comision. (2021). North Macedonia 2021 Report. Gjetet në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/north-macedonia-report-2021_en?fbclid=IwAR0kUDLDUuHAb33hTZqh-fyOdOJK5c2ocwtD1Fc2RFu06WuF0kREv4bRf1o

²⁹ Sulejman, D. dhe Breshkovski, I. (2022). Sulmet ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik 2017-2021 – Tendencë dhe rekomandime. SHGM. <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2022/06/Attacks-on-journalists-MK-310322.pdf>

³⁰ Sulejman, D. dhe Breshkovski, I. (2022). Sulmet ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatikë 2017-2021 – Tendencë dhe rekomandime. SHGM. <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2022/06/Attacks-on-journalists-MK-310322.pdf>

³¹ Sulejman, D. dhe Breshkovski, I. (2022). Sulmet ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik 2017-2021 – Tendencë dhe rekomandime. SHGM. <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2022/06/Attacks-on-journalists-MK-310322.pdf>

³² Spirovski, M. (2021). Indeksit i sigurisë së gazetarëve në Ballkanin Perëndimor, Raport narrativ Republika e Maqedonisë së Veriut 2020. SHGM. Gjetet në: https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2021/11/MK-Safety-Index-MKD_FINAL.pdf

Nga ato raste që arrijnë të hyjnë në procedurë gjyqësore, me përjashtim të disa shembujve pozitivë, më saktësisht një aktgjykim gjyqësor në rastin e gazetares Meri Jordanovska, praktika gjyqësore në rastet e ngacmimeve dhe sulmeve online nuk është në favor të gazetareve.

Gjithashtu, të dhënat tregojnë edhe për mungesën e një sistemi adekuat të regjistrimit të të dhënave për rastet nga ana e autoriteteve.³³ gjë që e bën të pamundur një pasqyrë të detajuar të seriozitetit të problemit, dhe në këtë mënyrë edhe krijimin e masave dhe politikave të duhura për ta trajtuar atë.


Megjithatë, nëse marrim parasysh jo efikasitetin e deritanishëm të institucioneve përkatëse në trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore në hapësirën fizike, fatkeqësisht do të jetë shumë e vështirë në periudhën e ardhshme të pritët një qasje serioze ndaj rasteve të raportuara në hapësirën digjitale, për arsyt që tashmë u analizuan.

³³ Ristova, O. (2022). Boshllëqet kryesore sistimore dhe zgjidhjet e mundshme për të përmirësuar mjedisin e përgjithshëm në shoqëri, nga aspekti i sigurisë së gazetarëve dhe punonjësve mediatik - dokument politikash. SHGM. Gjetet në: https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2022/02/AJM_BTD_Bezbednost-novinarite_MK_AL_EN.pdf


Anketa

Karakteristikat demografike të të anketuarave

Pothuajse gjysma (46,6%) e gazetareve të anketuara i përkasin kategorisë së moshës nga 35 deri në 44 vjeç, ndërsa vetëm 2 gazetarë (1,9%) janë të moshës nga 18 deri në 24 vjeç (grafiku nr. 1). Sipas vendbanimit, vetëm 7 nga gazetarët e anketuara jetojnë jashtë Shkupit, edhe atë në Shtip, Manastir, Kumanovë dhe Ohër, ndërsa 93,2% jetojnë në kryeqytet (grafiku nr. 2).




Grafiku nr. 1: Moshë




Grafiku nr. 2: Vendbanimi

Për sa i përket llojit të mediave ku punojnë, pothuajse gjysma (48,5%) e gazetareve të anketuara janë të angazhuara në portal online, 30% punojnë në televizione, ndërsa 12,6% në media të shkruara (grafiku nr. 3). Nga gazetarët, pjesa më e madhe, gjegjësisht 48,5%, janë gazetarë të punësuar. 22,3% e të anketuarave punojnë në pozita redaktuese, ndërsa vetëm 9,7% janë kryeredaktore. Vetëm 6 nga të anketuarat, gjegjësisht 5,8%, e identifikojnë veten si pronarë të mediave (Grafiku nr. 4).



Grafiku nr. 3: Media në të cilin jeni të angazhuar




Grafiku nr. 4: Pozicioni në të cilin punoni te media


Madje 80,6% e të anketuarave punojnë si gazetare për më shumë se 10 vjet, gjë që tregon përvojën e konsiderueshme në punën gazetareske.

Aktivitetet në hapësirën digjitale

Të gjitha gazetaret e anketuara punojnë në krijimin e përmbajtjeve mediatike që publikohen online. Për sa i përket aktivitetit të tyre në rrjetet sociale, shumica e gazetareve (53,4%) nuk publikojnë pikëpamjet dhe mendimet e tyre për politikën publike apo ngjarjet ditore politike në rrjetet sociale, ndërsa 27,2% e bëjnë këtë (Grafiku nr. 5).




Grafiku nr. 5: A i postoni pikëpamjet dhe mendimet tuaja për politikën publike apo ngjarjet ditore politike në rrjetet sociale?



Grafiku nr. 6: A jeni përballur ndonjëherë me ngacmime online për shkak të punës Suaj?

Një numër i konsiderueshëm i gazetareve, gjegjësisht madje 81,6%, janë përballur me ngacmime online për shkak të punës së tyre (Grafiku nr. 6). Prej tyre, 89,9% kanë përjetuar ngacmime përmes platformës Facebook. Një numër më i vogël, gjegjësisht 24,7% janë ngacmuar në Twitter, 15,7% në Viber dhe 6,7% në Instagram (Grafiku nr. 7).



Grafiku nr. 7: Në cilën platformë jeni përballur me ngacmime online?

Sipas gazetaresve, motivi i ngacmimit më së shpeshti ishte për shkak të publikimit të artikujve gazetareskë që synonin qendrat e tjera të fuqisë (56,6%), në 43,4% të rasteve për shkak të publikimit të shkrimeve të veta gazetareske për zhvillimet shoqërore që ishin kritike ndaj pushtetit, në 36,1% për shkak të artikujve të botuar gazetareskë për ngjarje shoqërore që ishin kritike ndaj ndonjë partie politike. Një numër i vogël i gazetaresve u ngacmuan si rezultat i shprehjes së pikëpamjeve dhe mendimeve personale për zhvillimet shoqërore që ishin kritike ndaj pushtetit (24,1%) dhe ndaj ndonjë partie politike (18,1%) (Grafiku nr. 8).



Grafiku nr. 8: Cili mendoni se ishte motivi për ngacmimin online?

Në përvojat e prezantuara, disa nga gazetaret shkakun e ngacmimit e gjetën në rolet tradicionale gjinore, veçanërisht në sfera që ende perceptohen kryesisht si “mashkullore” në shoqërinë tonë, si për shembull sporti, ekonomia dhe të ngjashme.

Si gazetare sportive, shpesh përballem me nënçmime dhe ofendime të llojit “a nuk gjetët ndonjë burrë të shkruaj për sportin”, “rri në shtëpi gatuaj drekën”, “tezja këmbëngul të shkruajë”, “nuk e ke idenë e sportit”. (Biljana Bllagoeska Petrusheva)

Me këtë rast, vetë identiteti (i supozuar) gjinor i gazetares është bazë për degradimin e profesionalizmit të saj.


Femrat nuk mund të analizojnë tema që janë të “natyrës mashkullore”.
(gazetare në TV dhe media të shkruar)

Mënyrat se si është demonstruar ngacmimi i të anketuarave janë të ndryshme, por më dominueset janë komentet nën produktin gazetaresk (tekstin, videon) që është shpërndarë në rrjetet sociale (63,7%), përmendja e emrit dhe mbiemrit

të gazetares në rrjetet sociale në konotacion negativ për shkak të punës së saj gazetareske (50,5%), si dhe kërcënimet, fyerjet, ngacmimet në mesazhe personale përmes rrjeteve sociale (47,3%).

Kanë bërë edhe montazhe të fotografive të mia, përmes të cilave shtrembërohet pamja ime fizike. Komentet nën tekste, mesazhet në inboks janë vetëm një pjesë e kësaj. (R.Z., gazetare në medie të shkruar dhe online)


29,7% e gazetareve kanë pasur raste të shpërndarjes së fotografive të tyre në grupe të caktuara në rrjetet sociale, me qëllim të diskreditimit të tyre. 22% e gazetareve janë përballë me përndjekje online, ndërsa fushata të orkestruara janë organizuar kundër 18,7% prej tyre (Grafiku nr. 9).



Grafiku nr. 9: Një çfarë mënyre jeni ngacmuar?

Një person mediatik postoi një fotografi time të vjetër dhe të koleges sime dhe në postimin shkruhej “jeni të shëmtuara e edhe bluzat i keni të shëmtuara”. U shqetësova mjaft, sidomos nga komentet poshtë fotografisë, ku bëhej thirrje për të “na varrë”, “rrahur” dhe një sërë komentesh të tjera me konotacion seksual, si dhe gjuhë urrejtjeje. (S.A., gazetare e pavarur)

Sipas përmbajtjes së ngacmimeve online, më së shumti bëhej fjalë për gjuhën e urrejtjes në 69% të rasteve ndërsa në raste tjera u demonstrua seksizëm (51,7%) dhe shovinizëm (43,7%). 24,1% e gazetareve kanë marrë kërcënime për dhunë fizike, kurse 19,5% kanë marrë kërcënime për jetën e tyre (Grafiku nr. 10).



Grafiku nr. 10: Cila ishte përmbajtja e ngacmimeve dhe sulmeve online?

Derisa punoja në një gazetë të përditshme, madje jam kërcënuar drejtpërdrejt me likuidim fizik. (bashkëpunëtorë në një portal online)

Disa gazetarë theksojnë lehtësinë me të cilën edhe komunikimi i thjeshtë shkakton sjellje agresive dhe reagime të ekzagjeruara.

Vërej rregullisht komente me gjuhë të urrejtjes nën artikujt e botuar, ku lexuesit bëjnë thirrje për “djegje” të gazetarëve për shkak të gabimeve gramatikore dhe lëshimeve të ngjashme. Kjo më ra në sy sepse ofendimet janë shumë të mëdha për një banalitet të tillë. (Ivana S., gazetarë në një portal online)


Një koment i shëmtuar lidhur me një tekst të shkruar, nën një postim që e kam shpërndarë në profilin tim personal në Twitter. Si njeri që kam qenë aktive në rrjetet sociale për një kohë të gjatë, nuk u trondita, por nuk isha rehat për momentin pasi që ekspozimi im ndonjëherë i shkakton dikujt nxitje për të fyer ose për të qenë agresiv në mënyrë verbale. (Ana Golejshka Xhikova)

Në shumicën e rasteve (79,3%) gazetarja nuk e njihje personalisht ngacmuesin (Grafiku nr. 11) dhe një pjesë e konsiderueshme e gazetarëve (70%) janë ngacmuar nga tre ose më shumë persona (Grafiku nr. 12).


Më shpesh ngacmimi bëhet nga persona që bëjnë të njëjtën gjë edhe me koleget e tjera dhe disa prej tyre përdorin profile të rreme. (redaktore në TV)

Përveç komenteve publike në profilin tim personal në Facebook, por edhe në profilin e medias ku janë publikuar tekstet, kam marrë edhe disa mesazhe në inboks, edhe pse

asnjë nga komentuesit nuk është mik imi në rrjetet sociale. (J.P., bashkëpunëtorë me honorar)




Grafiku nr. 11: A e njihni personalisht ngacmuesin?



Grafiku nr. 12: Sa njerëz të ndryshëm Ju kanë ngacmuar në internet?

Është shqetësues fakti se kur u pyetën nëse ngacmimi online me të cilin janë përballur ishte organizuar nga dikush apo ishte nga individë, madje 36% e gazetareve u përgjigjën se dhuna online ishte e organizuar (Grafiku nr. 13).


Tashmë disa vite jam duke u përballur me ngacmimet online, të cilat më së shumti janë në formë të bullizmit dhe kryhen nga “trolle” anonime dhe jo anonime, por edhe nga persona aktivë në politikë dhe në jetën publike. Pothuajse në të gjitha rastet arsyeja e ngacmimit kanë qenë shkrimet e mia gazetareske kritike ndaj qeverisë, kurse ngacmimi ndodh publikisht dhe pas publikimit nga individë që kanë qenë pjesë e institucioneve, apo janë përkrahës të partive politike. (redaktore në një organizatë mediatike)



Grafiku nr. 13: A mendoni se ngacmimi online që e keni përjetuar është organizuar nga dikush, apo është bërë nga individë?

Ndikimi i ngacmimit online në punë dhe shëndetin mendor

Për sa i përket frekuencës, shumica e gazetareve janë përballur me ngacmime online 5-10 herë (29,1%) dhe 2-4 herë (24,3%). Vetëm 12,6% e gazetareve nuk janë përballur kurrë me ngacmime online (Grafiku nr. 14).



Grafiku nr. 14: Sa shpesh jeni përballur me ngacmime online?

Ngacmimi i përjetuar nga shumica (74,3%) e gazetareve femra nuk ka shkaktuar ndryshim në sjelljen e tyre të mëtejshme. Kështu, për shembull, disa prej tyre


deklaruan se e shpërfillin përmbajtjen shqetësuese që u drejtohet, duke e pranuar atë si pjesë të profesionit.

Nuk reagoj, nuk u përgjigjem komenteve dhe kritikave ofenduese. Puna ime është publike dhe jam pajtuar me faktin se rrjetet sociale janë bërë një vend ku ka një fluks të përditshëm reagimesh negative. (D.Z., gazetarë e pavarur)


Por, injorimi nuk ka rezultuar gjithmonë të jetë një strategji e suksesshme.

Në fillim i injorova duke menduar se duke mos u dhënë rëndësi do të hiqnin dorë. Disa hoqën dorë, por shumica jo, e u shfaqën edhe “një milion të tjerë”, disa të njohur, shumica të panjohur, kurse një pjesë e konsiderueshme e tyre me identitet të fshehur. (redaktore në TV)

6,9% e gazetareve menduan të tërhiqeshin nga gazetarja si pasojë e ngacmimeve, 5,9% e ndërprejnë publikimin për tema dhe përmbajtje të caktuara, ndërsa vetëm 3% u larguan nga platforma ku ka ndodhur ngacmimi online (Grafiku nr. 15). Te më pak se gjysma (39%) e gazetareve që kanë përjetuar ngacmime online, kjo ka ndikuar në autocensurën e tyre në rrjetet sociale (Grafiku nr. 16).



Grafiku nr. 15: Cili ishte reagimi juaj pas ngacmimit online?




Grafiku nr. 16: A ju bën ngacmimi i vazhdueshëm online të vetëcensuroheni në mediat sociale?

Fotografitë e mia u shpërndanë në Facebook në grupe të ndryshme dhe nën fotografi kishte një sulm të orkestruar me gjuhë urrejtjeje, fyerje, kërcënime për dhunë fizike, seksizëm dhe shovinizëm. I raportova në Facebook, në shoqatat kompetente të gazetareve, si dhe në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Edhe pse dija përmbajtje u hoqën, megjithatë kjo nuk ishte pengesë që sulmi i orkestruar të vazhdonte. Kam përjetuar kërcënime për jetën time edhe në mesazhe personale në inboks tim në Facebook. Meqenëse e gjithë kjo më shqetësonte nga aspekti psikik, vendosa të largohesha nga ky rrjet. (S.Zh., pronare e një portali online)

Mesazhet në Facebook as që i hap më, Twitter-in e fshiva fare sepse aty ishte situata më shqetësuese. (Sashka Cvetkovska)

Ndjenja mbizotëruese tek gazetaret që ka rezultuar nga ngacmimet online ka qenë ndjenja e shqetësimit të pothuajse gjysma (46,6%), ndërsa tek një përqindje pak më e vogël, gjegjësisht të 35,9%, ka shkaktuar ankth. 26,2% e gazetareve kishin ndjenja neutrale lidhur me ngacmimet e përjetuara si rezultat i pritjes dhe i shprehisë për një sjellje të tillë negative në punën e tyre (Grafiku nr. 17).



Grafiku nr. 17: Si u ndjetë pas ngacmimit online?

Nuk kam reaguar asnjëherë dhe as nuk kam pasur nevojë të raportoj diku, megjithëse ka pasur raste kur ngacmimet kanë vazhduar. Zakonisht këto situata i zgjidh duke i bllokuar ngacmuesit. Nuk shqetësohem, nuk ndihem keq, jam mësuar. Megjithatë, ky është një profesion publik dhe është normale që dikujt t'i pëlqejë diçka që publikohet, e dikujt jo. (Antonija Popovska)


Me përjashtim të vetëm 6 gazetareve, asnjëra nga 95,1% e gazetareve të tjera nuk ka kërkuar asnjë lloj mbështetjeje dhe ndihmë psikologjike. Nga ata që kanë kërkuar ndihmë, shumica prej tyre u janë drejtuar për ndihmë familjarëve dhe miqve, kurse një pjesë më e vogël redaksisë ku punojnë.

Ajo që i zbuti disi këto fyerje dhe kërcënime ishte mbështetja e kolegëve dhe miqve, të cilët në mënyrë masive reagues ndaj sjelljeve dhe sulmeve të tilla. (Sunçica Unevski)


Redaktori i mediave sociale i monitoron komentet dhe i raporton ato. Unë zgjedh që të mos i lexoj, sepse më shkaktojnë nervozë të panevojshme, sidomos për faktin se komentet e tilla është e pamundur të ndalen. (Marija Mitevski)

Asnjë nga gazetaret që janë përballur me ngacmime nuk mendon se ngacmimi nuk do të përsëritet, përkundrazi, shumica e gazetareve mendojnë se ka shumë gjasa që kjo të ndodhë përsëri (81,6%).

Në 16% të rasteve të ngacmimeve online, ngacmimi ka kaluar edhe offline (Grafiku nr. 18). Shumica e gazetareve (76,8%) nuk ndiejnë frikë për sigurinë e tyre fizike si pasojë e kërcënimeve online (Grafiku nr. 19).



Grafiku nr. 18: Nëse jeni ngacmuar online, a ka vazhduar ky ngacmim edhe offline?



Grafiku nr. 19: A keni frikë për sigurinë tuaj fizike për shkak të kërcënimeve online?

Unë kam marrë kërcënime shpesh në punë për një temë që ka të bëjë me mjedisin jetësor, nga një bashkëpunëtor i ngushtë i një politikani, kam marrë kërcënime në telefon, më ka thënë se nuk do të jetë mirë për mua dhe familjen time, gjegjësisht “të mos i fus hundët aty ku në duhet”. Megjithatë e bëra temën, pavarësisht presioneve dhe nuk pati pasoja më pas. (kryeredaktorja e një portali online)

Edhe pse dhuna në internet rrallëherë përshkallëzohet në hapësirën fizike, megjithatë ajo imponon një shqetësim serioz për sigurinë e tyre. Kështu, një gazetare deklaroi se pas një serie artikujsh me fyerje dhe shpifje, të cilat nuk ndaleshin, të shoqëruara me kërcënime për jetën, më dhanë mbrojtje policore. (Miroslava Burns)

Gjithashtu, kërcënimet për dhunë fizike ndonjëherë nuk kanë të bëjnë vetëm me gazetaren konkrete, por e përfshijnë edhe mjedisin e saj të afërt.

Gjëja më e keqe ishte kur filluan t’i prekin edhe fëmijët. Kam marrë ofendime seksiste edhe ndaj fëmijëve të mi. (udhëheqëse/prezantuese e lajmeve televizive)

Disa ngacmime i kam denoncuar, disa nga ofendimet i hesht, edhe pse kjo ka një efekt të keq si për mua, ashtu edhe për familjen time, sidomos nëse ofendimet janë publike, të shoqëruara me fotografinë time dhe të përhapura në rrjetet sociale. (Meri Jordanovska)


Sipas disa gazetarëve, ngacmimet shpesh vijnë nga përfaqësues të partive politike, si dhe nga funksionarë të mëparshëm dhe aktualë.

Ne inboks jo rrallë më arrijnë kërcënime të llojit “do ta shohësh kur të kthehem, do të shkatërrojmë gjithçka, do t’i presim pa mëshirë ata që janë si ti, kujdes çfarë shkruan, mos bëj armiq, në vend që të kënaqesh nëse je me partinë tonë, ti po bën armiq». Këto mesazhe shpesh vijnë edhe si “këshilla qëllimmira” nga aktivistë partiakë që janë miqtë e mi personal apo profesional në jetën private. (bashkëpunëtore në një agjenci lajmesh)

Në rrjetet sociale ka pasur më shumë raste të ngacmimeve. Me ofendime, kërcënime për dhunë fizike. Ato vinin kryesisht nga aktivistë partiakë. Nuk i jam përgjigjur asnjë kërcënimi apo fyerjeje, sepse nuk dua të hyj në dialog me njerëz të tillë. (redaktore në TV)

Mbrojtja dhe mbështetja

Pothuajse gjysma (43,7%) e gazetareve të anketuara nuk e kanë raportuar rastin e ngacmimit online. Nga ata që kanë raportuar, më së shpeshti këtë e kanë bërë në redaksi, gjegjësisht 32%, ndërsa 19,4% kanë raportuar në organin kompetent dhe 18,4% ndonjërin nga organizatat gazetareske. Një pjesë e vogël (19,4%) kanë raportuar rastin në vetë platformën online, gjegjësisht në Facebook (Grafiku nr. 20).



Grafiku nr. 20: A e keni raportuar rastin/rastet?

Përkundër faktit se shumica (86,4%) e gazetareve janë përgjigjur se e dinë se në cilin institucion duhet të drejtohen për t'i raportuar ngacmimet online, vetëm 25,2% e kanë raportuar ngacmimin në institucionin kompetent.

Raportimet në institucione përfundojnë pa sukses. Kjo i inkurajon ata të vazhdojnë të kërcënojnë dhe të ngacmojnë. Kjo, nga ana tjetër, ndikon në punën time dhe me kolegët e mi, vijmë në një situatë të autocensurës, sidomos kur bëhet fjalë për intervistat e liderëve të partive politike, sepse atëherë kërcënimet janë më të shpeshta dhe më të shumta. (redaktore në TV)

Kam marrë kërcënime për jetën time dhe jetën e njerëzve të familjes sime për artikujt që i kam shkruar për një funksionar të asaj kohe. Kërcënimet u realizuan shpejt me një sulm paralajmërues para redaksisë. Kam raportuar vetëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa privatisht janë përdorur edhe qendra të tjera të fuqisë që dhunuesi ta ndalojë dhunën. U ndjeva e dëshpëruar dhe e shqetësuar për sigurinë time dhe të njerëzve të mi të dashur. Isha edhe e indinjuar sepse në raste të këtilla nuk ka mbrojtje, vetëm një paralajmërim nga MPB-ja dhe sigurisht vendim nëse duhet të fillojë një proces gjyqësor. (gazetare televizive)

Disa nga gazetaret arsyen e mos raportimit të ngacmimit e gjejnë në legjislacionin joadekuat.

Unë personalisht nuk kam raportuar, ende nuk kemi një ligj të tillë sipas të cilit do të sanksionoheshin ata që komentojnë nën postimet. Njerëzit komentojnë, shpesh edhe komentet janë seksiste. Tani për tani nuk ka një rregullim të tyre, përveç fshirjes së tyre. (gazetare në një portal online)

Megjithatë, siç mund të përfundohet nga shumica e deklaratave të gazetareve, mos raportimi i rasteve të ngacmimeve zakonisht është rezultat i shkallës së lartë të mosbesimit në institucione, pavarësisht se a bëhet fjalë për policinë, prokurorinë apo gjyqësorin.

Vetëm një herë kam raportuar një kërcënim online, por nga policia kam marrë përgjigje se nuk mund të bëjnë asgjë derisa të kryhet vepra. Pas asaj ngjarjeje nuk kam besim te institucionet, prandaj edhe nuk kam raportuar më asgjë. I injoroj mesazhet që më vijnë në Facebook dhe Viber, ndërsa media përpiqet t'i fshijë komentet e tilla nën postimet nga artikujt e mia. (Kristina Atovska)

Ashtu siç shtoheshin fyerjet dhe kërcënimet, disa prej tyre i kam denoncuar, por nuk ka pasur rezultat. Kurrë nuk kam ndjerë frikë, por revoltë dhe mllef, për shkak të mosfunksionimit të institucioneve. (redaktore në TV)

41,9% e gazetareve që kanë raportuar ngacmime dhe sulme online ishin shumë të pakënaqura nga bashkëpunimi me institucionet. Vetëm 2 gazetarë (6,5%) ishin të kënaqura.

Një person, identitetin e të cilit e di vetëm pjesërisht, të më përndjekë dhe ngacmojë në Facebook, të shkruajë komente nën postimet e mia dhe postimet në të cilat komentoj, komente që përmbajnë jo vetëm sharje dhe fyerje të llojit më të tmerrshëm, por edhe kërcënime për sigurinë time. Rasti është denoncuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në Sektorin e krimeve kibernetike, ku më kanë marrë në pyetje dhe kanë marrë të dhëna, dhe pas kësaj ngacmimit, të cilat më herët kanë zgjatur me muaj, përfundimisht u ndërprejnë. (Jugoslava Dukovska)

Në të njëjtën kohë, kohëzgjatja e procedurave, si dhe rezultati përfundimtar i tyre, ndikon ndjeshëm në motivimin e gazetareve për t'i raportuar rastet.

Njërin nga rastet që kam denoncuar në polici e ka marrë përsipër prokuroria. Megjithatë, kjo ka ndodhur në vitin 2019 dhe ende nuk kam informacion se në

çfarë faze është dhe pse hetimi po zgjat kaq shumë. Provat që i dhashë pothuajse më humbën, kujtesa ime u zbeh dhe interesi im për drejtësinë pas kaq shumë vitesh u zbeh ndjeshëm. (redaktore dhe gazetare në TV)

Katër vjet pas kërcënimit të parë online, mora një vendim se kallëzimi penal ishte refuzuar pasi që kërcënimet nuk ishin eksplicite aq sa duhet, ndërsa fakti që njeriu posedonte armë nuk do të thoshte asgjë. (Katerina Sinadinovska)

Megjithatë, disa nga gazetaret deklaruan se nuk ishin të kënaqura as me veprimet e shoqatave të gazetarëve në të cilat i kishin raportuar rastet e ngacmimeve online.

Rasti u raportua në SHGM dhe avokati më tha se nuk kishte bazë të mjaftueshme për padi edhe pse gjuha e urrejtjes dhe thirrjet për dhunë ishin shumë të qarta. Ai më sugjeroi të ngrija një padi private, gjë që nuk e bëra sepse vetë natyra e rastit nuk ishte private. Unë isha në orar të punës [në vendin e punës] dhe e gjithë ngjarja lidhej me punën time si gazetare. (redaktore dhe gazetare në TV)

Rastin (e ngacmimit nga një gazetare tjetër) e kam denoncuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe në Sektorin për krime kompjuterike të tyre, nga ku më kanë njoftuar se nuk mund të veprojnë dhe se problemin duhej ta zgjidhja vetë përmes padisë civile ndaj saj. Rasti është raportuar edhe në Facebook, por as nga aty nuk kanë reaguuar. Kurse zhgënjimi im më i madh ishte nga SHGM-ja, të cilët as që e panë të nevojshme që ta qortonin, me arsyetimin se “ajo ishte kolege jona dhe se ata nuk ndërhyjnë në zënkat mes kolegëve gazetarë”. (kryeredaktorja e një portali online)

Për sa i përket raportimit të përmbajtjeve shqetësuese përmes platformës Facebook, pavarësisht se disa gazetare e kanë përdorur këtë mjet, megjithatë asnjëra prej tyre nuk ka paraqitur ndonjë përvojë pozitive, gjegjësisht në asnjë nga rastet e raportuara postimi nuk është hequr.


Disa nga gazetaret i prezantuan edhe përvojat e mbështetjes së pamjaftueshme nga personat përgjegjës në median ku punojnë, të cilët nuk ndërmarrin aktivitete (si p.sh. fshirja e komenteve shqetësuese e të ngjashme) me qëllim të rritjes së vlerësimit të medias së tyre.

Videoja u shpërnda edhe nga ndjekës tjerë të personave në fjalë, kështu që në inboks filluan të më vinin mesazhe fyese. Lu drejtova drejtorit të programit, por komenti i tij ishte “mirë është, e shohin emisionin”. Si u ndjeva? Për çdo ditë

dhimbje koke, pata një neveri ndaj punës dhe emisionit, singërisht është një ndjenjë e mjerueshme, sidomos kur ka kush të të mbrojë në ato momente. (udhëheqëse/prezantuese e lajmeve televizive)

Komentet nën produktet gazetareske, si fyerjet, gjuha e urrejtjes, sikur janë bërë të zakonshme viteve të fundit, duke pasur parasysh se portalet nuk i heqin komentet, të cilat e tërheqin publikun, duke e rritur kështu shtrirjen e vetë postimit. (gazetare në një portal online)


Ka një ndarje mes gazetaresve për sa i përket parandalimit të ngacmimeve dhe sulmeve online, kështu që gjysma e tyre konsiderojnë se ato mund të parandalohen, ndërsa gjysma tjetër nuk pajtohen me këtë deklaratë. Sipas shumicës së gazetaresve (36,4%), ngacmimi online mund të parandalohet përmes sanksionimit adekuat të ngacmuesve, si dhe përmes veprimit efikas të institucioneve kompetente në këto raste (23,6%). 16,4 e gazetaresve parandalimin e shohin në ngritjen e vetëdijes, si tek publiku ashtu edhe tek vetë gazetarët, ndërsa 10,9% konsiderojnë se është i nevojshëm miratimi i legjislacionit përkatës që do ta mbulojë këtë fushë (Grafiku nr. 21)



Grafiku nr. 21: Si mund të parandalohen sulmet dhe ngacmimet online?


Parandalimi i vetëm është autocensurimi, por nuk e kam ndërmend të bëj këtë, andaj nuk mendoj se sulmet mund të parandalohen. (Kristina Atovska)

Shumica e gazetareve (31,1%) kanë një qëndrim neutral lidhur me pyetjen se sa gazetarët, kolegët dhe shoqatat i kushtojnë vëmendje ngacmimeve në internet dhe ofrojnë mbështetje, kurse shpërndarja e përgjigjeve që konsiderojnë se ofrohet shumë (14,6%) ose shumë pak (15,5%) vëmendje dhe mbështetje është pothuajse e njëjtë (Grafiku nr. 22).




Grafiku nr. 22: Sa gazetarët, profesionistët e fushës së gazetarisë, shoqatat, i kushtojnë vëmendje ngacmimeve online dhe ofrojnë mbështetje?

Një e treta e gazetareve (32%) konsiderojnë se nuk ka trajnime të mjaftueshme profesionale për sigurinë digjitale dhe personale apo për mekanizma të tjerë ekzistues për raportimin e ngacmimeve dhe abuzimeve në platformat digjitale dhe rrjetet sociale, ndërsa shumica (64,1%) konsiderojnë se është e nevojshme të punohet edhe më shumë lidhur me këtë problem (Grafiku nr. 23). 72,8% e gazetareve e shohin përgjegjësinë për organizimin apo zhvillimin e këtij lloj trajnimi tek shoqatat, 61,2% tek institucionet, 59,2% tek redaksitë, ndërsa 35,9% deklarojnë se këtë duhet ta bëjnë organizatat joqeveritare (Grafiku nr. 24).



Grafiku nr. 23: A ka trajnime të mjaftueshme profesionale për sigurinë digjitale dhe personale apo mekanizma të tjerë për t'i raportuar maltretimet dhe abuzimet në platformat digjitale dhe rrjetet sociale?



Grafiku nr. 24: Kush duhet të jetë përgjegjës për organizimin/realizimin e trajnimeve?

Intervistat me palët përkatëse të interesit

Sipas të intervistuarave, rrjetet sociale në vendin tonë, veçanërisht platforma Facebook, janë kthyer në një hapësirë në të cilën është transferuar pjesa më e madhe e komunikimit dhe socializimit, veçanërisht gjatë pandemisë së virusit Covid-19, e me këtë edhe ngacmimet dhe sulmet online.

Sipas Teodora Cvetkovskës nga Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik (SPGPM) *ngacmimi në internet ekziston që kur ekzistojnë edhe vetë mediat sociale. Megjithatë, fytyrën e vërtetë të maltretimit në rrjetet sociale e pamë me fillimin e pandemisë, sepse njerëzit ishin të mbyllur në shtëpi dhe sikur nuk kishin çfarë të bënin tjetër veçse të rrinin në internet.*

Megjithatë, ajo që është jashtëzakonisht shqetësuese janë sulmet e organizuara online që shpesh janë të motivuara dhe të mbështetura politikisht. Për Kristina Ozimec nga Platforma për Gazetari Hulumentuese dhe Analiza (PINA) *ajo që është më shqetësuese në vitet e fundit është "sekreti i hapur" për maltretimin e organizuar në internet ndaj kujt do që do të jetë i zëshëm dhe kritik ndaj politikave të caktuara. Sulmet i ngajnë ngacmimeve të organizuara online, duke filluar me shpifje, gënjeshtër dhe që synojnë degradimin e gazetareve si personalitete dhe profesioniste në gazetari, për të shkaktuar mosbesim në shkrimet e tyre gazetareske. Përveç sulmeve në internet nga persona me emra dhe mbiemra që shpesh i synojnë*

gazetaret, ka edhe sulme online nga “trolle” anonime në Twitter, zakonisht për shkak të ndonjë artikulli, procedure ose deklarate të gazetares.

Në të njëjtën kohë, rrjetet dhe mediat sociale janë kthyer në një mjet të fuqishëm që në mënyrë të pashmangshme ka sjellë edhe shumë sfida.

Me kalimin e viteve ka ndryshuar roli i rrjeteve sociale, ku të gjithë jemi të pranishëm për arsye nga më të ndryshmet dhe jeta zhvillohet kryesisht atje. Në rrjetet sociale është zhvendosur edhe loja në politikë, pasi partitë politike kanë njohur mundësinë për kontroll të narrativeve përmes rrjeteve sociale.³⁴

Që nga viti 2014, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) mban Regjistër të sulmeve ndaj gazetareve dhe punonjësve mediatic dhe është vërejtur trend i rritjes së numrit të sulmeve ndaj gazetareve. Millan Spirovski nga SHGM deklaroi se *në 5 vitet e fundit vihet re një tendencë e rritjes së numrit të gazetareve që alarmojnë se përballen me kërcënime online dhe gjuhë urrejtjeje në rrjetet sociale, kryesisht në Facebook dhe në mesazhet private në Messenger. Mirëpo, deri më tani nuk kemi raportim nga ndonjë gazetarë për ndonjë rast të tillë.³⁵*

Kristina Ozimec nga PINA konsideron se *gjëja më shqetësuese është se ky lloj i sjelljes është normalizuar në profesionin e gazetarëve, me arsyetimin se i tillë është profesioni, duhet të kemi “lëkurë të trashë” etj. Si rezultat i kësaj, ndonjëherë injorohen shumë gjëra të palejueshme dhe të rrezikshme. Disa nga ato gjëra që thuhet online nuk do të toleroheshin kurrë offline, kështu që nuk e di pse do të vepromin ndryshe.*

Kur bëhet fjalë për dimensionin gjinor të sulmeve online, të gjithë të intervistuarat i vunë në dukje stereotipat gjinore në shoqërinë tonë si bazë për dhunën, të cilat pothuajse asnjëherë nuk e marrin parasysh profesionalizmin e gazetareve.

Shumë shpesh qëllimi është diskreditimi i gazetareve, për t'i bërë ato më pak profesionale, duke aluduar në stereotipat gjinore dhe sa ato janë emocional në kryerjen e detyrës. Motivi më i zakonshëm për ngacmimin e gazetareve është veprimtaria kritike që e kryejnë përmes punës së tyre. E kam ndjerë edhe vetë, sapo bëhem më e zëshme, atëherë aktivizohen sulmet.³⁶

³⁴ Intervistë me Kristina Ozimec, PINA.

³⁵ Intervistë me Millan Spirovski, SHGM.

³⁶ Intervistë me Kristina Ozimec, PINA.

Si rrjedhjë, sulmet online më së shumti lidhen me pamjen fizike të gazetareve, si dhe sulme me konotacion seksual.

Komenti më i zakonshëm që marrin kolegët meshkuj është se janë budallenj, ndërsa ne (gazetaret) përveç asaj që jemi budallaqe marrim një sërë komentesh fyese lidhur me pamjen tonë fizike, a jemi të martuara, a kemi fëmijë... njerëzit i lejojnë vetes të na komentojnë dhe të shërbejnë si thes boksi kujtdo që i vjen ndërmend.³⁷

Në kuadër të diskutimit publik që e organizoi disa muaj më parë Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut (KHM) në temën “Dhuna kibernetike – siguria dhe autocensura”, një nga konkluzionet ishte se hapësira digjitale, në vend të një mjedisi demokratik që mundëson zhvillimin, është kthyer në një hapësirë ku cenohet autonomia e grave dhe rezultojnë në autocensurë dhe tërheqje. Sipas Sllavica Anastasovskës nga KHM, *më shpesh në shënjestër janë femrat nga jeta publike dhe më shpesh bëhet fjalë për kërcënime dhe fyerje që në thelb burojnë nga stereotipat gjinore dhe rolet gjinore, të cilat shumë shpesh si cak kanë pamjen fizike të grave.*

Sipas të intervistuarave, sulmet online vijnë nga burime të ndryshme dhe mund të kenë forma të ndryshme. Kështu, përkundër faktit se në shumicën e rasteve bëhet fjalë për individë që thjesht kanë ndodhur para tastierës, megjithatë nuk janë të rralla edhe ngacmimet e organizuara politikisht ndaj disa gazetareve.

Ngacmimi mund të kalojë shumë lehtë nga hapësira online në hapësirën fizike dhe për këtë patëm një aktgjykim gjyqësor dy vjet më parë. Rrallëherë personi që ka iniciuar gjuhën e urrejtjes është i vetëdijshëm për atë që e shkruan dhe për pasojat që mund t'i shkaktojnë. Shumë shpesh fillon në mënyrë naive, por ka një efekt domino që nuk mund të kontrollohet.³⁸

Të gjithë të intervistuarat konfirmojnë se ekziston autocensura, por se forma e saj mund të jetë e ndryshme. Sipas Kristina Ozimec nga PINA, autocensura është një nga rreziqet më serioze të sulmeve online, duke pasur parasysh vetë thelbin e profesionit të gazetarit. Ajo thotë se sulmet online e prekin lirinë e mediave dhe lirinë e gazetareve. *Ata nuk e bëjnë këtë rastësisht. Nëse nuk do të kishte ndikim, as që do ta bënin.³⁹*

³⁷ Intervistë me Teodora Cvetkovskën, SPGPM.

³⁸ Intervistë me Teodora Cvetkovskën, SPGPM.

³⁹ Intervistë me Kristina Ozimec, PINA.

Teodora Cvetkovska nga SPGPM-ja konsideron se dhuna online *ndikon shumë më tepër në shëndetin mendor sesa që e pengon punën e gazetareve. Mendoj se autocensura është më e pranishme lidhur me paraqitjen e jetës së tyre private në rrjetet sociale.*

Atë që SHGM-ja e ka vënë re përmes punës së tyre hulumtuese si një fenomen interesant, është ajo se *gazetaret zakonisht nuk reagojnë ndaj ngacmimeve online. Ajo që ne si shoqatë përpiqemi ta bëjmë është t'i inkurajojmë që të gjitha komentet e pahijshme dhe kërcënimet t'i raportojnë në shoqatën tonë ose me ndihmën tonë në MPB.*⁴⁰

Sipas të gjithë të intervistuarve, numri i rasteve që raportohen, qoftë edhe tek shoqatat, është tepër i vogël, pavarësisht se shumica e gazetareve e njohin ngacmimin online.

*Në periudhën e fundit kemi pasur vetëm një rast të ngacmimit online të një gazetareje për të cilën është bërë kallëzim penal për gjuhë urretjeje, i cili është interpretuar si thirrje për përdhunim në Twitter. Në këtë rast, kishte edhe gjuhë të urretjes edhe dhunë me bazë gjinore, por kallëzimi u refuzua.*⁴¹

Ata konsiderojnë se arsyeja e mosraportimit është rezultat i mosbesimit në institucione, përkatësisht trajtimi joefektiv i rasteve të ngacmimeve dhe sulmeve ndaj gazetareve në hapësirën digjitale.

*Drejtësia duhet të jetë efikase dhe efektive, sepse nuk ka kuptim që ngjarjet të procedohen disa vite pasi kanë ndodhur.*⁴²

Sipas Millan Spirovski nga SHGM-ja, gazetaret *nuk raportojnë sepse konsiderojnë se letargjia e institucioneve dhe plogështia e sistemit të drejtësisë mund të mos u ndihmojë, por përkundrazi ta përkeqësojë situatën më tej.*⁴³

Për sa i përket punës së Sektorit për Krime Kompjuterike dhe Forenzikë Digjitale, sipas Sllavica Anastasovska nga Komiteti i Helsinkit, joefikasiteti i Sektorit është për shkak të mungesës së kuadrit të trajnuar.

⁴⁰ Intervistë me Millan Spirovski, SHGM.

⁴¹ Intervistë me Sllavica Anastasovska, KHM.

⁴² Intervistë me Sllavica Anastasovska, KHM.

⁴³ Intervistë me Millan Spirovski, SHGM.

Ekipi që punon në këtë Sektor është shumë i vogël, kurse ai sektor është përgjegjës për një sërë krimesh të tjera të rënda, si për shembull mashtrimet kompjuterike, të cilat sipas tyre janë me prioritet për t'u trajtuar.⁴⁴

Sa i përket legjislacionit, pavarësisht potencialit premtues që e sollën ndryshimet në Kodin Penal, megjithatë shumica e të intervistuarve mendojnë se është plotësisht e mundur të veprohet edhe në kuadër të rregulloreve ekzistuese ligjore.

Sigurisht që është i nevojshëm përmirësimi i legjislacionit, veçanërisht në fushën e kriminalizimit të dhunës me bazë gjinore në hapësirën online, por edhe aplikimi i zgjidhjeve ekzistuese ligjore, si për shembull neni 144 i Kodit Penal për veprën e Rrezikimit të sigurisë, i cili parashikon kryerjen e këtyre veprave edhe me anë të sistemit informatik.⁴⁵

Një nga qëllimet mbrojtëse të SHGM-së është krijimi i njësive të posaçme apo personave përgjegjës në kuadër të prokurorive publike që do të specializohen për punë në raste që kanë të bëjnë me gazetarët dhe punonjësit mediatik, me qëllim të krijimit të një sistemi më efikas të parandalimit dhe mbrojtjes, gjegjësisht të një procedure të shpejtë dhe efikase që do të kontribuojë në reduktimin e kërcënimeve dhe sulmeve.

SHGM-ja dhe SPGPM-ja ofrojnë ndihmë juridike falas për gazetarët, njejtë si dhe KHM, por nuk kanë mundësi të ofrojnë mbështetje psikologjike për gazetaret.

Me qëllim të parandalimit të dhunës online, të gjithë të intervistuarit theksuan nevojën e kryerjes së fushatave të vazhdueshme publike për ngritjen e vetëdijes për dhunën online dhe pasojat negative të saj, edukim që do të përfshijë edhe edukimin mediatik, si dhe informimin e vazhdueshëm të gazetareve për mbrojtjen në hapësirën digjitale.

Një nga bazat e parandalimit është lufta kundër paragjyqimeve dhe roleve gjinore në shoqërinë tonë, të rrënjësor që në moshë të re, si përmes fushatave publike, ashtu edhe përmes procesit arsimor.⁴⁶

⁴⁴ Intervistë me Sllavica Anastasovska, KHM.

⁴⁵ Intervistë me Sllavica Anastasovska, MKH.

⁴⁶ Intervistë me Sllavica Anastasovska, KHM.

Kristina Ozimec konsideron se me PINA-n, e zbuluam në kohë këtë problem serioz që u ndodh gazetarëve dhe pikërisht për këtë duam të kontribuojmë në ngritjen e vetëdijes, si të gazetaret ashtu edhe të publiku, për atë që po na ndodh dhe si mund të ndryshojmë diçka lidhur me këtë trend shqetësues. Për më tepër, duhet të përfshihen të gjitha organizatat, por edhe institucionet dhe së bashku të gjenden pengesat, ligjore apo institucionale dhe të arrihet deri te zgjidhja.⁴⁷

⁴⁷ Intervistë me Kristina Ozimec, PINA.

/ PËRFUNDIME /

Për të pasur një pasqyrë më të qartë të gjetjeve kryesore që dolën nga analiza e kryer, përfundimet do të paraqiten duke i përcaktuar anët e forta, të cilat paraqesin bazën për përmirësimin e mëtejshëm të situatës në këtë fushë, kundrejt anëve të dobëta, si rreziqe që duhet eliminuar, me qëllim që të sigurohet mbrojtje adekuate e gazetareve.

Anët e forta

- Rritja e interesit për t'u marrë me dhunën digjitale dhe pasojat e saj, veçanërisht mbi femrat;
- Niveli i lartë i vetëdijes së gazetareve për njohjen e dhunës dhe pasojave negative të saj;
- Informimi i mirë i gazetarëve për mekanizmat ekzistues të mbrojtjes, institucionale dhe jointucionale;
- Ruajtja e nivelit të lartë të profesionalizmit në kryerjen e punës gazetareske pavarësisht sulmeve;
- Gazetarët tashmë aplikojnë disa strategji për t'u përballur me dhunën online dhe disa prej tyre i konsiderojnë të suksesshme;
- Ndjenja e frikës për sigurinë e tyre fizike është rrallë e pranishme tek gazetaret
- Dhuna online rrallë transferohet në hapësirën offline;
- Gazetarët kanë në dispozicion ndihmë juridike falas, kryesisht përmes shoqatave;
- Rritja e pjesëmarrjes së gazetarëve në grupet e punës për hartimin e ligjeve në fushën e mediave;
- Ndryshimet e propozuara në Kodin Penal premtojnë përmirësimin e situatës me sigurinë dhe mbrojtjen e gazetareve në hapësirën digjitale.

Anët e dobëta

- Ndjeshmëria dhe ndërgjegjësimi i pamjaftueshëm gjinor për problemin e dhunës online tek publiku, strukturat drejtuese në kuadër të mediave dhe institucionet kompetente;
- Kapaciteti i pamjaftueshëm i institucioneve kompetente për të njohur dhe vepruar në rastet e dhunës me bazë gjinore në hapësirën digjitale;
- Veprimi joefikas nga të gjitha institucionet kompetente në rastet e dhunës online;
- Kohëzgjatja e procedurave, si dhe rezultati përfundimtar i tyre, i demotivon gazetaret për t'i raportuar rastet;
- Aplikimi i standardeve të dyfishta në efikasitetin e Sektorit për Krim Kompjuterik dhe Forenzikë Digjitale, varësisht nga funksioni i personit që është viktimë e dhunës online;
- Mungesa e sistemeve adekuate për mbledhjen e statistikave për rastet e dhunës online nga institucionet;
- Shkalla e lartë e mosraportimit të dhunës online nga gazetaret;
- Shkalla e lartë e mosbesimit të gazetareve në institucionet dhe veprimet e tyre në çdo nivel;
- Normalizimi i dhunës në internet si pjesë e profesionit;
- Relativizimi i seriozitetit të sulmeve online dhe pasojave të tyre, duke pasur parasysh se ato (kryesisht) nuk kanë pasoja fizike;
- Anonimiteti i sulmuesve nëpërmjet përdorimit të profileve të rreme dhe rrjeteve private virtuale, gjë që kontribuon në rritjen e guximit dhe sjelljen agresive;
- Rregulloret e pamjaftueshme ligjore në hapësirën digjitale, veçanërisht lidhur me kriminalizimin e dhunës online;
- Zbatimi joadekuat i rregulloreve ekzistuese ligjore nga institucionet;

- Mosreagimi nga platforma Facebook në rast të raportimit të ngacmimeve online;
- Përfaqësimi i ulët i femrave në pozitat më të larta në media, e me këtë edhe në proceset vendimmarrëse;
- Përfaqësimi i pamjaftueshëm i nevojave specifike të gazetareve në masat dhe politikat për siguri dhe mbrojtje në hapësirën digjitale;
- Ndikimi negativ në shëndetin mendor të gazetareve;
- Kërcënimet e drejtuara ndaj gazetareve nganjëherë zgjerohen edhe ndaj të afërmeve të tyre;
- Prania e sulmeve të organizuara, të cilat shpesh kanë prapavijë politike-partiake;
- Ekzistenca e rrezikut nga autocensura;
- Mungesa e rregullave dhe masave të përcaktuara në kuadër të vendit të punës për mbrojtjen e gazetareve në rastet e dhunës online;
- Mungesa e mbështetjes psikologjike për gazetaret që kanë përjetuar dhunë.

/ REKOMANDIME /

Institucionet

- Forcimi i kapaciteteve të të gjitha institucioneve relevante, veçanërisht MPB-së dhe Sektorit për Krime Kompjuterike dhe Forenzikë Digjitale, PTHP-ve dhe gjyqësorit, përmes trajnimeve për njohjen, kualifikimin dhe veprimin në rastet e dhunës me bazë gjinore në hapësirën digjitale, me fokus në zbatimin e parimit të kujdesit të duhur dhe ndalimit të (ri)viktimizimit, në përputhje me Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje (LPMDHGDHF);
- Promovimi dhe zbatimi i një qasjeje të ndjeshme gjinore nga institucionet relevante në rastet e dhunës online ndaj gazetareve, duke qenë se zakonisht bëhet fjalë për një veprim që klasifikohet si dhunë me bazë gjinore;
- Miratimi urgjent i ndryshimeve në Kodin Penal, veçanërisht lidhur me kriminalizimin e dhunës në hapësirën digjitale dhe sanksionimi adekuat i autorëve të kësaj lloji dhune;
- Harmonizimi i mëtejshëm i ligjeve tjera në fushën e medias me standardet e Bashkimit Evropian;
- Të definohet termi i maltretimimit në internet dhe rregullimi ligjor i tij, si dhe të përcaktohen masat për parandalim, pengim dhe mbrojtje;
- Zbulimi i dobësive dhe nevojave të Sektorit për Krime Kompjuterike dhe Forenzikë Digjitale në MPB për veprim efektiv në rastet e ngacmimeve dhe sulmeve online, si dhe vlerësimi i burimeve që ka në dispozicion Sektori për kryerjen e punës (numri i punonjësve, ekspertiza e duhur e punonjësve, teknologjia e duhur, mundësitë për avancimin e punës, etj.);
- Emërimi i një ose më shumë prokurorëve publikë që do të specializohen në këtë fushë, gjegjësisht do t'i trajtojnë rastet e sulmeve ndaj gazetareve dhe punëtorëve mediatik, ku do të përfshihet edhe trajtimi i rasteve të dhunës ndaj gazetareve;
- Sanksionimi adekuat i autorëve të dhunës, forcimi i efikasitetit të gjyqësorit dhe respektimi i urgjencës së procedurave për mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore

nga gjykatat, në përputhje me LPMDHGDHF;

- ❑ Institucionet kompetente (MPB-ja, PTHP-ja dhe gjyqësori) të fillojnë me krijimin dhe mbajtjen e evidencës për numrin e rasteve dhe format e dhunës me bazë gjinore (duke përfshirë edhe dhunën në hapësirën digjitale), të cilat do të ndahen sipas gjinisë, si dhe të dhëna të tjera (për shembull, futja e profesionit të viktimave të dhunës) relevante për monitorimin e situatës me dhunën me bazë gjinore, sipas LPMDHGDHF;
- ❑ Promovimi i mekanizmave mbrojtës, si për shembull Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, kompetencat e të cilit e përfshijnë edhe ngacmimin, në përputhje me Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi;
- ❑ Harmonizimi dhe koordinimi i sistemeve për mbledhjen dhe analizën e të dhënave për rastet e dhunës ndaj gazetaresve në hapësirën digjitale të të gjitha subjekteve që mbajnë statistika, me qëllim të kërkimit më të lehtë të të dhënave, pasqyrës më të mirë të seriozitetit të problemit dhe krijimit të masave dhe politikave adekuate mbrojtëse.
- ❑ Përmirësimi i bashkëpunimit dhe koordinimit të të gjitha institucioneve relevante me mediat dhe shoqatat e kësaj fushe, duke mbajtur takime koordinuese periodike ku do të prezantoheshin informacione aktuale për punën e institucioneve në këtë fushë dhe për problemet me të cilat përballen gazetarët dhe gazetaret lidhur me punën e institucioneve.

Publiku

- ❑ Realizimi i fushatave publike për ngritjen e vetëdijes për pasojat e dhunës në hapësirën digjitale, me fokus të veçantë në dhunën me bazë gjinore ndaj femrave dhe gazetareve;
- ❑ Realizimi i fushatave publike dhe aktiviteteve të tjera promovuese dhe edukative për rritjen e edukimit digjital të publikut të gjerë dhe promovimin e një kulture pozitive të komunikimit publik dhe përdorimit të përgjegjshëm të internetit;
- ❑ Kërkesë për liderët politikë dhe partiakë për angazhim publik dhe dënimin e çdo lloj dhune ndaj gazetarëve dhe gazetareve;
- ❑ Ndërmarrja e aktiviteteve për mbrojtjen dhe promovimin e parimit të tolerancës zero ndaj dhunës në hapësirën digjitale nga të gjithë aktorët relevantë, përfshi institucionet dhe shoqatat.

Gazetaret

- ❑ Realizimi i trajnimeve të vazhdueshme për gazetaret për mbrojtjen në hapësirën digjitale, me fokus në mediat sociale;
- ❑ Informimi i vazhdueshëm i gazetareve për të drejtat e tyre dhe të gjithë mekanizmat mbrojtës që i kanë në dispozicion në vend, si dhe shërbimet mbështetëse, përmes sesioneve informuese, shpërndarjes së materialeve informative etj.;
- ❑ Përfshirja e gazetareve në të gjitha proceset e krijimit të masave, ligjeve dhe politikave që kanë të bëjnë me sigurinë dhe mbrojtjen nga dhuna.

Mediat dhe shoqatat

- ❑ Forcimi i kapaciteteve të mediave, veçanërisht të strukturave drejtuese për njohjen dhe ndikimin e ngacmimeve dhe sulmeve online ndaj gazetareve dhe për nevojën për të ofruar mbështetjen dhe mbrojtjen e duhur në vendin e punës për gazetaret që përballen me këtë lloj dhune;
- ❑ Krijimi dhe sigurimi i qasjes së papenguar në shërbime të ndryshme nga ana e mediave dhe shoqatave për të mbështetur gazetaret që janë viktime të ngacmimeve dhe sulmeve online, duke përfshirë këshillimin psikologjik, ndihmën juridike falas dhe ndihmë tjetër profesionale;
- ❑ Krijimi i rregulloreve të brendshme për hapat që duhen ndërmarrë në rastet e dhunës online ndaj gazetareve, qoftë në mënyrë publike apo të drejtpërdrejtë, si dhe për sigurimin e mbrojtjes së gazetareve, duke respektuar të drejtën e fjalës së lirë;
- ❑ Caktimi i një personi përgjegjës brenda çdo media që shpërndan përmbajtje online, për të monitoruar dhe ndërhyrë në rast se shfaqen komente shqetësuese lidhur me përmbajtjet online;
- ❑ Krijimi i një sistemi për monitorimin dhe arkivimin e përmbajtjeve shqetësuese drejtuar gazetareve brenda çdo media, me qëllim të parandalimit dhe vlerësimit në kohë të rrezikut të përshkallëzimit të dhunës;
- ❑ Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit të mediave dhe shoqatave profesionale për mbrojtje të përbashkët në drejtim të gjetjes dhe zbatimit të zgjidhjeve për adresimin e problemit dhe aktualizimin e këtij problemi në përgjithësi.

/ BIBLIOGRAFIA /

- ❑ Antonijevic, Z. (2016). The media cannot be truly free if women's voices are silenced. Në: New Challenges to Freedom of Expression: Countering Online Abuse of Female Journalists. OSCE. Gjetet në: <https://www.osce.org/files/f/documents/c/3/220411.pdf>
- ❑ Bejkova Josheska, B. dhe Xhigall, S. (2022). Analizë – Siguria dhe situata socio-ekonomike në media: Me veprim të përbashkët deri te respektimin më të madh të të drejtave të gazetareve dhe punonjësve mediatik. SHGM dhe SPGPM. <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2022/03/Bezbedni-Mediumski-Rabotnici-Analiza-Book-WEB-MKD.pdf>
- ❑ European Commission. (2021). North Macedonia 2021 Report. Gjetet në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/north-macedonia-report-2021_en?fbclid=IwAR0kUDLDUuHAb33hTZqh-fyOdOJk5c2ocwtd1Fc2RFu06WuFOkREv4bRf1o
- ❑ Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë. (2021). Analizë: Liria e mediave dhe siguria e gazetarëve në RMV përmes prizmit të zgjidhjeve ekzistuese ligjore - Si të arrijmë deri te zgjidhjet më të mira? Gjetet në: <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2021/06/publikacija-MK-internet-1.pdf>
- ❑ IFJ global survey shows massive impact of online abuse on women journalists. <https://www.ifj.org/media-centre/news/detail/article/ifj-global-survey-shows-massive-impact-of-online-abuse-on-women-journalists.html>
- ❑ Khan, I. (2021). #JournalistsToo – Women Journalists Speak Out. Gjetet në: https://srfreedex.org/wp-content/uploads/2021/11/JT_English.pdf
- ❑ OSBE. (2019) Hulumtimi i kryer nga OSBE-ja mbi dhunën ndaj grave në Maqedoninë e Veriut: Mirëqenia dhe siguria e grave. Gjetet në: https://www.osce.org/files/f/documents/5/4/424409_0.pdf
- ❑ Petkovska, N. dhe Leshoska, V. (2021). Për kë është interneti një vend i sigurt? Dhuna me bazë gjinore në hapësirën online. Gjetet në: <https://glasprotivnasilstvo.org.mk/wp-content/uploads/2021/12/Za-kogo-internetot-e-bezbedno-mesto-finalno.-docx.pdf>

- ❑ Reporters without Borders. Gjendet në: <https://rsf.org/en/country/north-macedonia>
- ❑ Ristova, O. (2022). Boshllëqet kryesore sistemore dhe zgjidhjet e mundshme për të përmirësuar mjedisin e përgjithshëm në shoqëri, nga aspekti i sigurisë së gazetarëve dhe punonjësve mediatik - dokument politikash. SHGM. Gjendet në: https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2022/02/AJM_BTD_Bezbednost-novinarite_MK_AL_EN.pdf
- ❑ Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. (2021). Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje.
- ❑ Spirovski, M. (2021). Indeksi i sigurisë së gazetarëve në Ballkanin Perëndimor, Raport narrativ Republika e Maqedonisë së Veriut 2020. SHGM. Gjendet në: https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2021/11/MK-Safety-Index-MKD_FINAL.pdf
- ❑ Spirovski, M. dhe Nasteska Kallanoska, B. (2022). Maqedonia e Veriut: Treguesit për shkallën e lirisë së mediave dhe për sigurinë e gazetarëve në vitin 2021. SHGM. Gjendet në: <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2022/05/MK-MK-2021-finalen-izvestaj.pdf>
- ❑ Starova, N. (2022). Boshllëqet kryesore sistemore dhe zgjidhjet e mundshme për të tejkaluar hendekun e rrogave dhe problemet potenciale me vendosjen hierarkike në media të bazuara në diskriminimin gjinor – dokument politikash. SHGM. Gjendet në: https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2022/02/AJM_BTD_Rodova-diskriminacija-vo-mediumite_MK_AL_EN-1.pdf
- ❑ Sulejman, D. dhe Breshkovski, I. (2022). Sulmet ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik 2017-2021 – Tendenca dhe rekomandime. SHGM. <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2022/06/Attacks-on-journalists-MK-310322.pdf>
- ❑ Tuneva, M. dhe Sandev, L. (2022). Siguria e gazetarëve dhe punonjësve mediatik – realitet apo ndëshkim i vazhdueshëm. SHGM. Gjendet në: https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2022/03/MK_Bezbednost-na-novinarite-i-mediumskite-rabotnici-130322.pdf

- ❑ UN. (2020). Combating violence against women journalists: Report of the Special Rapporteur on violence against women, its causes and consequences. Gjendet në: <https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/G20/109/79/PDF/G2010979.pdf?OpenElement>
- ❑ US Department of State. (2021). 2020 Country Reports on Human Rights Practices: North Macedonia. Gjendet në: <https://www.state.gov/reports/2020-country-reports-on-human-rights-practices/north-macedonia/>
- ❑ Ferrier, M. (2018). Attacks and Harassment: The Impact on Female Journalists and Their Reporting. International Women's Media Foundation. Gjendet në: <https://www.iwmf.org/wp-content/uploads/2018/09/Attacks-and-Harassment.pdf>



#%@!\$

